

# RRETH PIKËPAMJES SË ÇABEJT PËR PRANINË E FOLKLORIT NË POEMAT E DE RADËS

Muharrem JAKUPI

Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti UFO, Tiranë, Shqipëri

E-mail: bakrina@msn.com

## PËRMBLEDHJE

Larmia e motiveve të këngëve popullore arkaike të shfrytëzuara në krijimtarinë poetike të De Radës. Këngët me motivin e dashurisë dhe të dasmës në rolin e *serenatave*; roli i tyre në prurjen dhe përforcimin e elementit lirik origjinal të poemave. Rëndësia e funksionalizimit poetik të motiveve të baladave dhe bestytive e paragjykimëve popullore në strukturat e poemave të De Radës. Njohja mes të rinjve dhe lindja e dashurisë tek kroi ose tek burimi, si moment i lidhjes së subjektit në poemat *Këngët e Milosaos* dhe *Serafina Topia*. Motivi i vdekjes së personazheve në çift si moment i kulmit dhe i zgjidhjes së "konfliktit" në këto poema; rëndësia e këtyre motiveve popullore në organizimin stilistik e ligjërimor. Mënyra e përvetësimit dhe e shkrirjes së motiveve të këngëve popullore me materialin poetik origjinal. Ruajtja e motivit, njëkohësisht, tjetërsimi i tekstit origjinal të këtyre këngëve në procesin e integritimit me lëndën poetike romantike, duke u bërë pjesë e kompozicionit të poemave apo e këngëve të caktuara të tyre. Tëhuajsimi romantik i këtyre këngëve e motiveve popullore si dhe roli i tyre në spikatjen e disa tipareve që shprehin origjinalitetin arbëresh (shqiptar) të brendisë. Vënia e këtyre motiveve folklorike në funksion të shprehjes së idealit, filozofisë dhe estetikës romantike

në suazën e poemave të De Radës.

**Fjalët kyçe:** *Këngët e dashurisë, baladat arkaike, paragjykimet popullore, funksioni liriko-epik, tëhuajsimi romantik, origjinaliteti arbëresh, filozofia dhe estetika romantike.*

**Key words:** *Heart songs, archaic ballads, popular prejudices, lyrical-epic function, romantic transformation (germ.: Verfremdung), arbëresh originality, romantic philosophy and esthetics.*

Çabej ka meritën e madhe se u dha tiparet e një dijeje sistematike **studimeve albanologjike**, duke e prishur sinkretizmin e tyre tradicional me hulumtimet amatore e sporadike, me ndihmesën e të cilit zhvillimi i tyre u zhvendos përfundimisht nga jashtë, brenda Shqipërisë. Për rëndësinë tematike, nivelin e lartë shkencor, vëllimin dhe fushën e gjerë të përhapjes e zbatimit të produkteve të tij intelektuale, për modelet e kërkimeve që krijoi për të tjerët nëpërmjet koncepteve teorike dhe metodave nga më të efektshmet e kohës së vet, me të cilat ai mbajti gjithmonë kontakt dhe i zbatoi në mënyrë tepër rigorozë, Çabejt i takon merita më e madhe në krijimin e albanologjisë si shkencë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Tezat e tij, duke qenë të mbështetura në fakte të gjetura me shumë mundim, vështirësi e kujdes dhe të shqyrtuara me një logjikë analitike të thelluar, u bënë gurë

themeli dhe pika referimi për zgjerimin e dijeve të mëvonshme në këtë fushë. Prandaj ne i kthehemi atij vazhdimisht, jo vetëm për ta nderuar si ikonën kryesore të shkencave albanologjike, por edhe për të përtërirë kujtesën me tezat dhe përfundimet e tij, për të krijuar përshtypjen e duhur mbi botën e dijeve dhe origjinën e referencave të tij. Nga ana tjetër, me një figurë të tillë është nder ndonjëherë edhe të dialogosh, meqë ai gjithmonë e ka lënë të hapur këtë mundësi...

**Shkenca e letërsisë**, gjithashtu, mban vulën e disa tezave themeluese pikërisht prej Prof. Çabejt. Në vëmendje të tij ka qenë posaçërisht periudha romantike e letërsisë sonë. Ndër tezat e tij më të goditura janë ato që kanë të bëjnë me gjenezën e letërsisë shqipe (1938-1939) dhe me përhapjen e romantizmit në Ballkan e në Shqipëri (1945). Një ndër autorët më pak të trajtuar, me analiza e konstatime brenda universit përkatës artistik, të cilat koha i vërtetoi si të argumentuara saktë e të qëndrueshme është pikërisht De Rada. Në kuadrin e një fushe më të gjerë studimi, që ka të bëjë me gjuhën e kulturën arbëreshe Çabej e vlerëson De Radën si një nga majat më të larta të krejt kulturës e letërsisë shqipe: "Nga veprat e poetit për ne nuk ka dyshim se kryet e vendit e zë "Milosao". Kjo poemë idilike e me frymëzim romantik e përshkruar fund e krye me poezinë naive-arkaike të rapsodive shqiptare t'Italisë, për karakterin e ngjeshur që ka, mbetet një nga ato fort të pakta vepra të literaturës shqiptare që e bëjnë këtë të përfaqësohet në literaturën botërore" (Çabej, 1987: 115).

Duke e shqyrtuar ndikimin e folklorit gojor në veprën poetike të De Radës me profesionalizmin e një komparativisti të nivelit të lartë dhe me një erudicion që të mahnit, nga pozitat e sotme teoriko-letrare mund të thuhet, gjithsesi, se Çabej e zmadhon disi rolin e poezisë popullore në universin artistik të lartpërmendur, kur thotë se "... De Rada e jetoi këtë poezi dhe gjeti në të ushqimin e tij. Ajo formoi bazën e natyrshme të veprës së poetit. Kjo vepër në përmbajtje të saj, në stil, në gjuhë, në trajtën e brendshme, në krahasime, në frymëzimin e saj, në përshkrimin e atmosferës ku lëvizin heronjtë, na paraqitet shumë e ngjashme, shpeshherë e njëjlojtë me rapsoditë popullore, ajo duket sikur të ishte një vazhdim i këtyre rapsodive" (Çabej, 1987: 113). Kjo

thënie është bërë nën ndikimin e shkollës së studi-meve krahasuese në letërsi te ai: kërkimi dhe gjetja e motiveve (*invarianteve*). Himnizimi i këtij ndikimi të plotë shkonte përshtat me estetikën dhe filozofinë romantike siç tregojnë edhe referencat. Shkolla e romantizmit gjerman, në veçanti, duket se e ka magjepsur në mënyrë topitëse.

Megjithatë, në kumtesën e tij me titull "*Vatra dhe bota në poezinë e De Radës*"\* shtohet ndjeshëm hulumtimi komparativist edhe rreth ndikimeve të De Radës nga letërsia e kultivuar botërore. "Kështu mendoj se në disa figura e motive të poemave të tij vihen re gjurmët e poemave italiane të Renesansës, sidomos të Ariostos e të Tassos, i shumë literaturave europiane është edhe motivi i dashurisë fatkeqe të një çifti që rrjedh prej dy familjesh armike, motiv që te poeti ynë na del në figurat e Bozdar Stresit e të Serafina Topisë në Artën e kohës së Skënderbeut" (Çabej, 1987: 114). Çabej, pasi identifikon invariantet e shumta nga Bajroni, nga letërsia antike dhe ajo indiane, saktëson se "Ideja e fatit (moira), siç na çfaqet në dramën greke, sidomos te Sofokliu, depërton edhe në veprat e poetit tonë. Edhe Bibla ka lënë mbresa të thella tek ai". (Çabej, 1987: 114).

Pas këtij hulumtimi të Çabejt marrëdhëniet intensive intertekstuale të poemave të De Radës me letërsinë popullore tradicionale si dhe me kryeveprat e letërsisë botërore mund të pranohen pa mëdyshje. Një depërtim të folklorit në poemat e kultivuara të De Radës dhe sintezën e tyre me elementin me origjinë nga letërsia e kultivuar e tregojnë që në fillim poemat *Këngët e Milosaos* dhe *Serafina Topia*. Pas takimit të rastit te kroi të Milosaos me Rinën dhe përfshirjes së tyre prej një flake dashurie të beftë, krejt sipas motiveve të këngëve popullore, në zbatim të një projekti të vetin kompozicional, poeti vazhdon me një ndërfitje prej letërsisë së kultivuar: pikërisht midis Milosaos dhe Rinës zbulohet menjëherë diferencimi i madh i shtresave sociale të cilave këta të rinj u përkasin. Po kështu në poemën tjetër, Serafina bie në dashuri me Bozdarin, i cili rrjedh nga një fis armik

\* Shkëputur prej punimit *Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare*. Këtë fragment, por me disa plotësime, Çabej e bëri publik me rastin e 150-vjetorit të lindjes së këtij poeti (1964).

me familjen e saj. Motivi letraresk i dallimeve dramatike midis dy të dashuruarve plotësohet edhe me motivin e djalit të kthyer nga studimet. Vetë Milosaoja është një i tillë, kurse tek *Serafina* po ky motiv hyn edhe në këngën e parë, në përmbajtje të një krahasimi të zgjeruar dhe jo si pjesë integrale e subjektit. Kështu teksti i poemave shkon deri në fund sipas këtij parimi kompozicional, të cilit i nënshtrohen elementet e thirrura aq shpesh prej folklorit, prej bestytnive popullore dhe motiveve apo personazheve prej letërsisë botërore.

Edhe mbyllja e poemave na sjell fuqishëm tek motivi i këngëve popullore arkaike, megjithëse në një mënyrë mjaft të transfiguruar prej efekteve të një subjekti origjinal. Këto motive në kuadrin e vijës formale të fabulës i nënshtrohen një integrimi organik me filozofinë e patosin romantik të pesimizmit, në aspektin teknik të formatuara sipas tipologjisë së këngëve popullore. Vdekjet e personazheve në çifte vërtetojnë aksiomën me origjinë bestyde se pranë qiparisit do të prehet përjetë edhe molla e bardhë; siç u deshën në këtë jetë ata do të duhen edhe në përjetësi.

Ajo që pohon Çabej rreth ndikimit të folklorit arkaik arbëresh, me anë figurash e motivesh, duket sikur të lë përshtypjen e një lënde që grimcohet e shpërndahet në mënyrë mozaikale nëpër tërësinë e teksteve poetike të De Radës: *“Ka dhe mjaft motive, mjaft skena e episode në veprat e tij që i gjejmë më parë në rapsoditë popullore, e të cilat nuk është vendi të përmenden këtu. Ndërkaq me këto ndikime nuk do menduar se poeti nuk bëri gjë tjetër veçse imitoi ku mundi poezinë popullore. Ai mori prej saj frymëzimin e përgjithshëm dhe shumë elemente që meritojnë të hetohen në të ardhmen, po jo pa i ngritur këto në një sferë poetike më të lartë. Poezia popullore që për të një pikënisje, nga e cila mori hovin për të krijuar një botë poetike më vete”* (Çabej, 1987: 113-114). Orvatja rreth këtyre elementeve që mund të hetohen në të ardhmen bëhet shkaku kryesor dhe detyra kryesore e këtij punimi.

Vlerësimi i Çabejt për *Milosao*n se është përshkuar fund e krye nga poezia naive-arkaike nuk i lë vend domosdo kuptimit se këto poema kundërmojnë vetëm erë myku të një folku naiv. Mbetja e studiuesit brenda detyrës së një *komparativizmi përshkrues* ka lënë rastin t’i shpëtojë diçka esenciale

rreth strukturës, si pasojë edhe rreth vlerës origjinale artistike të veprave poetike të De Radës. Kjo diçka ka të bëjë pikërisht me mënyrën e përfshirjes dhe të funksionalizimit artistik të “lëndës së huaj” në këto poema. Kjo lëndë me origjinë nga vepra të tjera është nënshtruar dhe gllabëruar plotësisht nga një parim artistik kompozicional i përgjithshëm, nën ndikimin e të cilit ajo e ka humbur mjaft “origjinalitetin” e saj burimor. Në kuadrin e së tërës këto elemente “ndërtuese”, në kontekstin e pozicionin e ri, artistikisht asnjansë, nuk sjellin e nuk garantojnë domosdo as vlera artistike dhe as ndonjë tipologji artistike burimore, megjithëse mbajnë pasaportën e një origjine artistike. Në këtë kuadër, ato mund të jenë me status të njëjtë me materialin e mirëfilltë jetësor, tepër prozaik, të prerë nga jeta e përditshme e fshatarëve të varfër, të cilët paraqiten në shumë skena ku vuajnë duke nxjerrë bukën e gojës me një punë rraskapitëse.

Por humbja artistike që ato pësojnë në rolin e “lëndës ndërtuese”, nga ana tjetër, funksionalizohet poetikisht duke u dhënë një origjinalitet të mahnitshëm dhe vlera të larta këtyre poemave. Desemantizimi i tillë artistik i elementit folklorik (dhe jo folklorik) të huazuar nga De Rada shpërblehet me funksionalizimin e tyre nga një aspekt tjetër, më i gjerë e ndoshta më i rëndësishëm, në role e mënyra që Çabej, të paktën, nuk i ka artikuluar shprehimisht, edhe pse bën fjalë për mjaft elemente të tjera që “nuk është vendi të përmenden këtu” dhe për ngritje të tyre “në një sferë poetike më të lartë”. Kjo ngritje kemi hetuar se ka të bëjë kryesisht me parimet kompozicionale, sipas të cilave funksionon në mënyrë të mahnitshme subjekti tërësor dhe krejt përmbajtja e poemave. Takimi i protagonistëve pranë kroit lidh një dashuri të tillë të fortë që shpejt do të rrjedhë drejt një fundi fatal, konkretizuar në vdekjet “folklorike” të dashnorëve, ku bashkë me dashurinë fatkeqë shterohet edhe jeta biologjike e personazheve. Shtjellimi i argumentit të kësaj analize do të paraqitet në vijim.

Vdekjet njëra pas tjetrës të personazheve të poemave, si: Milosao-Rina, Serafina-Bozdari, Parayllja-Radavani etj. shikojmë se nuk kanë të bëjnë vetëm me zgjidhjen e linjave përkatëse të subjektit, por ato bëhen edhe mishërim i një

filozofie e botëkuptimi të caktuar të autorit për jetën. Prandaj ndoshta jeta e këtyre personazheve "rrëfehet" gjer në fundin e saj, cak që shtyhet më përtej dashurisë së tyre a lumturisë familjare dhe që ka çuar në prekjën e asaj që në poemat e De Radës është quajtur *fatalitet*. Në fakt poeti ka bërë përpjekje për të dhënë tablonë e gjithë jetës së personazheve të veta, pavarësisht se kjo përgjithësisht është strukturuar sipas konvencioneve letrare të njohura të një fabule dashurie fatkeqe. Prandaj kur kjo dashuri është shuar në rrethana nga më të ndryshmet, atëherë personazhe si Milosaoja, pasi ka ngelur pa Rinën e tij, nuk ka më jetë interesante, por shkon drejt vdekjes. Gjithashtu Serafina vdes menjëherë pas Bozdarit, sepse "aventura" e tyre artistike pikërisht në këtë moment ka mbaruar.

Në tërësinë e subjektit të poemave vdekja merr kuptim të dyfishtë: kur shterohet fabula e dashurisë, përfundon bashkë me këtë edhe jeta e personazheve përkatëse. Prandaj një përfundim i tillë, edhe pse duket sikur reflekton modele paralele të letërsisë botërore, në thelb bëhet sipas modeleve tipike të disa këngëve popullore arkaike, por edhe sipas një ligji artistik, që tjetërsohet në parimin filozofik të botës artistike të poemave: fataliteti që determinon jetën e njeriut, që kërcënon pa mëshirë dashurinë dhe çdo formë tjetër lumturie. Mirëpo poeti e shfrytëzon edhe vdekjen fataliste të personazheve për të metaforizuar pikërisht *përjetësinë e dashurisë* sipas botëkuptimit bestyld të këtyre këngëve arkaike të dashurisë. Pas përfundimit të poemave mbetet pezull gjithmonë një pjesë e pashkruar teksti ku vdekja (e personazheve) sfidohet përmes dashurisë së amëshuar. Kjo është sfida filozofike ambivalente që i bën De Rada filozofisë pesimiste dhe vdekjes biologjike.

Folklori është funksionalizuar artistikisht nga De Rada më tepër për lëndën e motiveve fabulative që afron. Vetë përpunimi i motivit jep më shumë dorë për origjinalitet tekstual sepse krijon mundësinë që motivi të transformohet në tjetërsim. Subjekti i veprës artistike gjithmonë është në gjendje ta gllabërojë lëndën "ndërtuese" të shfrytëzuar. Vetë shkrimtari ndjen nevojën të tregojë se sa në gjendje është të bëjë tekst, pastaj botë, pastaj krejt ngjarjen a historinë letrare. Me të njëjtat funksione është përdorur edhe lënda e huazuar nga

letërsia e kultivuar. Duke u ndërturur e duke iu nënshtruar ristrukturimeve artistike subjekti i poemave të De Radës gjithmonë e më tepër u largohet ngjashmërive në aspektin që po flasim. Lënda folklorike dhe etnologjike është funksionalizuar me rolin e ndërtimit të botës dhe të motiveve më të përpunuara. Kështu prania statike, hapësinore e folklorit e humb gjithmonë e më tepër funksionin që elementet e tij kishin kur përbënin etnitete artistike të pavarura.

Është vetë Çabej që e vë në dukje origjinalitetin e ri të përftuar: "*Burimet e poezisë popullore shqiptare e të literaturës botërore e pasuruan krijimin poetik të De Radës, po kjo në qenësi mbetet pjella e frymëzimit të tij*" (Çabej, 1987: 115). Për të është e qartë se më e rëndësishme sesa lënda jetësore me të cilën është ngjizur apo frymëzuar një vepër arti është *mënyra sesi është strukturuar artistikisht ajo*, d.m.th. mënyra se si funksionon si vepër arti. Në këtë aspekt del edhe më në pah kompleksiteti i saj strukturor, që kthehet në një kompleksitet të ri kuptimor. Këto na i ka vërtetuar më mirë letërsia postmoderne dhe teoritë e saj letrare. Kjo letërsi ishte në gjendje të na rrëzojë morinë e paragjykimeve dhe iluzioneve tradicionale, si ato që vijnë nga fusha e studimeve letrare krahasuese, ashtu edhe ato që kanë të bëjnë me paragjykimin vlerësues tradicional, aq të vjetër, që ka të bëjë me plagjiaturën letrare.

Pikërisht tek poema *Serafina Topia*, "Kënga e mingëllës" merr një rol më të madh sesa duket në pamje të parë, si një motiv i huazuar nga folklori. Ajo është më shumë sesa prani folklori; ajo bëhet çelës hermeneutik dhe njëkohësisht parabolë e ngjarjes që përfshin subjekti si dhe mënyrë e mishërimit konkret të filozofisë dhe botëkuptimit jetësor romantik të autorit. Jo më kot kjo këngë gjendet në pjesën e parë të poemës, sepse nëpërmjet aftësive të veta parabolike, ashtu siç është risemantizuar brenda kontekstit të poemave, ajo sintetizon jo vetëm parimin artistik dhe filozofinë e poemës, por jep edhe çelësin e dekodifikimit të veprës, njëkohësisht edhe praninë e folklorit jo vetëm në mënyrën se si është përfshirë (meqë kemi *këngë* brenda *poemës*), por edhe në mënyrën e tij përfshirëse, gjersa është dominuese përmes funksionit të saj të rëndësishëm parabolik.

Kallëzohet *lashtit*, na u nda një herë  
 Prej vashëzës trimi dhe shkoi detit gjerë.  
 Vasha na e priti sa vashë më s'dukej,  
 Por nuk shih anije e shpresa m'i këputej.  
 Një mëngjes te zalli me shpirt helmrrëmbyer,  
 Në mingëll të hollë, vasha na qe kthyer!  
**As mplakej, as rritej.** Edhe një të hënë  
 Trimi shqotash rrahur pranë i qe gjendë.  
 Aq të bukur vasha kurrë s'e kish parë:  
 Me lule të bardha, pranë tij mbulohet  
 Për t'i thënë trimit "zemra më gëzohet!"  
 (De Rada, 1971: 66)

Këputja e shpresës e tjetëron vashën, duke e ngrirë rrjedhën e kohës. Strofa e fundit poetizon komunikimin shpirtëror të personazheve të afërta ndaj njëri-tjetrit, edhe pse ata tashmë gjenden në dy botë të ndryshme. Kjo është një këngë-çelës që na jep dritë për të kuptuar edhe më mirë parimin deradian të motivimit të arsyes së vdekjes së personazheve në çifte dhe të vënies së theksit mbi përjetësimin e dashurisë dhe afërsisë jetësore edhe pas vdekjes. Gëzimi personifikues i vajzës-bajame pas bashkimit simbolik me trimin e vet detar bartet edhe në vlerësimin e fateve njerëzore të personazheve të poemave të tij. Është baza e besimeve popullore dhe e atyre kristiane, njëkohësisht, një prej arsyeve të qarta përse De Rada flet shpesh nëpër vargje për përjetësinë dhe pafundësinë e botës e të jetës. Ndonëse *me subjekt të kundërt* me disa balada popullore arkaike që tregojnë vdekjen direkt njëri pas tjetrit të vashës e trimit dhe se në vendin ku ata vdiqën mbiu më vonë një qiparis e pranë tij një mollë e bardhë, kjo këngë transmeton të njëjtën filozofi të të qenit gjithmonë bashkë në "jetën" e amëshuar.

Procesi artistik i tjetërsimit të folklorit shënon kushtin minimal për një përkufizim të poemave të De Radës si art i kultivuar. Poemat e krijuara pas *Këngëve të Milosaos* dhe *Serafina Topia* e dëshmojnë këtë dukuri në mënyrë të pakundërshtueshme. Pikërisht kjo e fundit e vetë-pasqyron më mirë sesa e para letërsinë e kultivuar. Prandaj mund të thuhet pa mëdyshje se De Rada është mbështetur në poezinë popullore pa e folklorizuar artin e kultivuar, pa rënë në folklorizëm të mërzitshëm a banal. Elementi burimor i huazuar nga folk-

lori, bashkuar me elementin burimor të huazuar prej letërsisë së kultivuar tek De Rada kanë gjetur gjithmonë një modelim artistik original. Kështu poemat spostohen shumë nga shtrati autokton folklorik dhe transfigurohen në krijime artistike të kultivuara. Pasqyrimi në strukturat e tyre i vetë letërsisë, atë elemente të bollshme intertekstualiteti me letërsinë botërore, intertekstualiteti me poemat romantike të poetëve të tjerë arbëreshë dhe italianë, përbëjnë ato premisa të mjaftueshme për t'i cilësuar poemat e De Radës si art i larguar nga arti popullor, si nënshtrim të tij ndaj artit të kultivuar. Poemat e De Radës nuk janë folklorike, nuk janë as të folklorizuara në masë të tillë që të dëmtojnë origjinalitetin e tyre artistik.

Në lidhje me sa jemi duke përfunduar Çabej shprehet: "*Ndërkaq me këto ndikime nuk do menduar se poeti nuk bëri gjë tjetër, veçse imitoi ku mundi poezinë popullore. Ai mori prej saj frymëzimin e përgjithshëm dhe shumë elemente që meritojnë të hetohen në të ardhmen, po jo pa i ngritur këto në një sferë poetike më të lartë. Poezia popullore qe për të një pikënisje, nga e cila mori hovin për të krijuar një botë poetike më vete. Kjo botë është pasqyrim i kohës paraturke dhe i kohës së parë turke të Shqipërisë...*" (Çabej, 1987: 113-114).

Po përse atëherë në kompozicionin e jashtëm të *Këngët e Milosaos*, kënga e fundit që sjell lajmin e vdekjes së heroit kryesor është vendosur prej poetit pas këngës që bëhet një himn i natyrës dhe i përjetësisë së jetës e botës, dhe që luan gjithashtu rolin e një "Requiem" për vetë Milosaon? Sepse gjithë logjika rapsodike arbëreshe e vdekjes së dy njerëzve të dashuruar dhe domosdoshmërisë së mbirjes së qiparisit pranë mollës së bardhë, si dhe gjithçka tjetër që sjell në poemë botën arbëreshe, i është nënshtruar strukturimit sipas estetikës romantike dhe është në funksion të saj. Në këngën e fundit të poemës është duke rënë mbrëmja. Milosao bie në amëshim dhe bota empirike pëson një metamorfozë drejt metafizikes: ajo shndërrohet në "*nj'ëndërrë*"! Pasi ndodhin këto metamorfoza të strukturave të këngëve arkaike në struktura romantike, me anë termash të tilla si: *hije* (e lisit), *mbrëmje*, *ëndërr*, optimizmi naiv i baladave popullore zëvendësohet me metafizikën mitike romantike të së panjohurës, të së mrekullueshmes dhe të mospërmbushjes së ëndrrës. Ky nuk është një

modifikim i thjeshtë, por një shndërrim i madh estetik në përputhje të plotë me koherencën artistike të ngjarjes dhe filozofisë së shtruar në poemë.

#### PËRFUNDIME

Konceptet teorike të Çabejt në punime si më sipër prirën kryesisht drejt teorive të romantizmit, me praninë e ndonjë formulimi prej pozitivizmit, por pa pasur ndikim substancial prej tij, edhe pse hidhen ende teza në dobi të kësaj pikëpamjeje. Në esencë metoda e përdorur prej tij është ajo e studimeve krahasuese. Përfitimi shkencor që rrjedh prej studimeve të tilla mund të ndahet midis shkencave të tjera të kulturës dhe shkencës për letërsinë.

Duket se Çabej e shikon ndikimin e De Radës prej folklorit dhe kulturës popullore me bagazhin e formimit të tij prej tekstologu, gjuhëtari, kulturologu etj., dhe më pak si estet apo studiues letërsie. Duke qenë i formuar në klimën e kulturës klasike të dominuar nga romantizmi dhe idetë e tjera kombformuese, duke qenë i sprovuar në ushtrimin e metodave hulumtuese historiciste e krahasuese, duke pasur parasysh edhe parime prej shkollave sociologjike në studimin e letërsisë, ai hulumtoi me imtësi e profesionalizëm tërësinë e huazimeve të De Radës prej folklorit apo letërsisë së kultivuar të përbotshme. Kjo gjë bie në sy veçanërisht në kumtesën me rastin e 150-vjetorit të lindjes së De Radës.

Këto shqyrtime të Çabejt mbajnë vullën e kohës kur janë shkruar dhe të gjendjes së shkencës letrare në atë kohë. Shumë kohë ka kaluar që atëherë dhe mjaft teori të tjera kanë dalë dhe kanë revolucionarizuar së tepërmi studimin letrar. Edhe zhvillimi i praktikës krijuese, siç është modernizmi dhe veçanërisht postmodernizmi, kanë ushtruar ndikimin e tyre mbi shkencën për letërsinë.

Komparativizmi nuk e shpjegoi në mënyrë të kënaqshme anën dinamike të elementit të huazuar brenda një teksti letrar, aspekt mbi të cilin hedhin dritë më të qartë teoritë e intertekstualitetit, të krijuara në kuadrin e strukturalizmit e më pas. Praktika stilistike moderniste e postmoderne tregoi se vetëm prania e një elementi, pa marrë parasysh

funksionin e tij artistik, nuk është domethënës i plotë në strukturën e veprës letrare.

Procedimet artistike intertekstuale të De Radës ndoshta janë bërë me synimin për të befasuar me këtë material poetik dhe jo mirëfilli për të treguar “rrenjë” arbëreshe të veprave të tij. Këndvështrimi i Çabejt është përqendruar në rrafshin kulturor dhe ndërkulturor. Ai ka treguar se vepra e De Radës është kontribut shumë kulturash, d.m.th. prandaj edhe një krijim përfaqësues i nivelit botëror. Kjo nuk adresohet si një metaforë komplimentuese as për Prof. Çabejin dhe as për vetë De Radën. Por ata të dy ishin kapacitete të nivelit botëror dhe prandaj synuan nivelet e paradigmat botërore.

#### BIBLIOGRAFIA

*De Radës në 100-vjetorin e vdekjes.* Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Dita 2000, Tiranë.

CORBINEAU-HOFFMANN, A. (2000), *Einführung in die Komparatistik.* Erich Schmidt Verlag, Berlin.

ÇABEJ, E. (1987), *Në botën e arbëreshëve të Italisë.* ShB N. Frashëri, Tiranë.

ÇABEJ, E. (1994), *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes.* MÇM, Tiranë.

DEMIRAJ, S. (1990), *Eqrem Çabej.* ShB “8 Nëntori”.

DE RADA, J. (1974), *Këngë të Milosaut* (përshtati A. Varfi). ShB Naim Frashëri, Tiranë.

DE RADA, J. (1976), *Këngët e Milosaos* (përshtati Dh. Shuretqi). ShB Naim Frashëri, Tiranë.

DE RADA, J. (1971), *Serafina Topia* (përshtati A. Varfi). ShB Naim Frashëri, Tiranë.

HAMITI, S. (2002), *Letërsia filobliblike dhe letërsia romantike/ Vep. letrare 7.* F. Konica, Prishtinë.

JAKUPI, M.; XHINDI, E. (2004), “Izotopitë romantike dhe arbëreshe në poemat e De Radës”. Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Filologjisë: “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën, 22/2”; Prishtinë. Shtypur NBLG Dukagjini, Pejë.

KABASHI, E. (2003), *Jeronim de Rada/ Poetika e poemave.* Ombra GVG, Tiranë.

KODRA, K. (1988), *Poezia e De Radës.* Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë/ Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

QOSJA, R. (1990), *Historia e letërsisë shqipe/ Romantizmi II.* Rilindja, Prishtinë.

XHIKU, A. (1980), *Romantizmi arbëresh.* ShB Naim Frashëri, Tiranë.

ZIMA, P.V. (1992), *Komparatistik.* A. Francke Verlag, Tübingen.